

# **AKT THEMELIMI**

## **i Shoqërisë X&M LIMITED Shpk**

Sot, në Tiranë, më 17/12/2021, ne ortakët **Xhuljano Arben Veis dhe Muhamet Enver Dervishi**, hartojmë Aktin e Themelimit të shoqërisë **X&M LIMITED Shpk** sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijojnë:

### **Neni 1** **Themelimi**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është **X&M LIMITED Shpk**. (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

### **Neni 2** **Selia**

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Rruga e Elbasanit, Hyrja 1 Apartamenti 6, Nr i pasurisë 6/42+1-6, Vilumi 50, Faqe 191, Zona Kadastrale 8160.
- 2) Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

### **Neni 3** **Objekti**

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 1) Në fushën e ofrimit të shërbimeve në kërkimin dhe arkivimin në forëm elektronike e të dhënave të kontaktit për subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar dhe profesional, në mënyrë individuale ose si antarë të grupimeve profesionale ose drejtuesve të sipërmarrjeve private.

- 2) Konsulencë në sistemet elektronike të përpunimit të të dhënave .Shërbime për transmetimin e të dhënave .Kryerje marketingu online .
- 3) Instalim dhe montim serverash e aparaturash të ndryeshme hardware, mbështetje teknike për subjektet.Tregtim të pajisjeve elektronike.
- 4) Veprimtari të ndryeshme në teknologjinë informative dhe shërbime kompjuterike  
Si edhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimeve të biznesit e që nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi

#### **Neni 4** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 5** **Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm**

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 2(dy) pjesë vlera nominale e secilës pjesë është 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) lekë.  
Ortakët i Shoqërisë janë; Xhuljano Veis, atësia Arben i dtl. 20/06/1994 lindur në Korçë dhe banues në Tiranë identifikuar nga karta e identitetit me nr. 032668161. Numer personal J406201350 dhe Muhamet Dervishi, atësia Enver,i dtl.25/01/1990,lindur në Sakat ,Pukë dhe banues në Tiranë identifikuar nga karta e identitetit me nr. 033732603. Numer personal J00125076E.

#### **Neni 6** **Ortakët**

Ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

#### **Neni 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet këtij akti.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, Z. Xhuljano Veis, atësia Arben i dtl. 20/06/1994 lindur në Korçë dhe banues në Tiranë identifikuar nga karta e identitetit me nr. 032668161. Numer personal J406201350 i cilit zgjidhet për një afat për 5vjet.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8** **Audituesit ligjorë**

Audituesit ligjorë të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë Audituesin Ligjor.

#### **NENI 9** **Pjesmarrja**

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10** **Ngritja e degëve apo filialeve**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11** **Ruajtja e Sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12** **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.


#### **NENI 13** **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**X&M LIMITED Shpk**

**Xhuljano Veis**

Xhuljano Veis  


**Muhamet Dervishi**

Muhamet Dervishi  
